



**Republika e Kosovës – Republika Kosova**  
**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia**  
**Izborni Panel za Žalbe i Predstavke**

**Anr. 437/2014**

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Muhamet Rexha kryesues, Nenad Lazić dhe Xhevdet Abazi anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesën e paraqitur nga Bore Balaj kandidate për deputete për Kuvendin e Republikës së Kosovës nga radhët e Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), paraqitur kundër rezultatit përfundimtar të publikuar nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ) me datë 26.06.2014, për Zgjedhjet e Parakohshme Parlamentare, në seancën e panelit të mbajtur me 30.06.2014, mori këtë:

### **VENDIM**

**Refuzohet** si e pabazuar ankesa e Bore Balaj kandidate për deputete nga Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës.

### **Arsyetim**

PZAP-i, ka pranuar një ankesë më datë 27.06.2014, nga Bore Balaj kandidate për deputete për Parlamentin e Republikës së Kosovës nga radhët e Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës me të cilën pretendon se në rezultatet preliminare në formularin e KKZ-së në Fushë Kosovë i ka pasur 14 vota, ndërsa në rezultatet përfundimtare të publikuara nga KQZ i ka pasur 11 vota, që do të thotë se i janë hequr 3 vota. Po ashtu parashtruesja e ankesës potencon se rezultatet përfundimtare janë kontradiktore edhe sa i përket kandidates për deputete Melihate Tërmkollli e cila në rezultatit përfundimtar i ka pasur 2.589 vota, ndërsa në formularët e KQZ për komuna del se ky rezultat është 2586 që do të thotë tre (3) vota më pak se shifra përfundimtare e publikuar nga KQZ.

Parashtruesja e ankesës ka kërkuar nga PZAP-i që të verifikoj formularët e rezultateve përfundimtare të 38 komunave dhe të eliminoj parregullsitë që ekzistojnë në votat e saj.

PZAP-i, pasi që shqyrtoi dhe analizoi shkresat e lëndës gjeti se:

## **ankesa është e pabazuar**

PZAP-i konstatoi se pretendimet ankimore janë të pabazuara ngase parashtruesja e ankesës nuk e ka ofruar asnjë dëshmi për ti vërtetuar ato pretendime, po ashtu nuk ka dhënë asnjë udhëzim apo hollësi se ku mund të gjenden dëshmitë të cilat nuk i ka pasur në posedim lidhur me atë çka pretendon në ankesë.

Prandaj PZAP-i në mungesë të provave dhe dëshmive konkrete dhe bindëse për pretendimet e paraqitura në ankesë konstaton se ankesa në fjalë është e pabazuar dhe e pa argumentuar, andaj në kuptim të Nenit 118 paragrafi 1 të LZP-së, lidhur me ankesën në fjalë vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

### **Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia**

Anr. 437/2014 më datën 30.06.2014



**Kryesuesi i Panelit  
Muhamet Rexha**

#### ***Udhëzim Juridik:***

PZAP nuk do t'i pranojë kërkesat për ri-apelim, sepse vendimet e tij do të konsiderohen si përfundimtare. Prandaj, siç parashihet në Nenin 118.4 të LZP-së, *ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i, në rast se gjoba e përfshirë është më e lartë sesa pesëmijë (5, 000) Euro ose në rast se çështja prek një të drejtë themelore.*